



# REZULTATET E VLERËSIMIT PIRLS 2021

PIRLS (Progress in International Reading Literacy Study – Studimi Ndërkombëtar i Progresit në Lexim) është vlerësim ndërkombëtarë që vlerëson arritjet e nxënësve në lexim, organizohet që nga viti 2001 në shtetet e ndryshme të botës, është vlerësim që përsëritet pas çdo 5 viteve. Vlerësimi PIRLS në vitin 2021 është realizuar në 57 vende, ndërsa Kosova merr pjesë për herë të parë.

PIRLS 2021 ndodhi gjatë një periudhe dy vjeçare të pandemisë COVID-19.

## **Korniza e Vlerësimit PIRLS 2021**

PIRLS (Studimi i Progresit në Literaturën Ndërkombëtare) bën vlerësimin e aftësive në të lexuar (leximit). Leximi (aftësia e të lexuarit) është baza për arritje akademike të suksesshme të nxënësve në përgjithësi si dhe për ngritjet e tyre personale në veçanti.

PIRLS – nocioni i gjerë që do të thotë aftësia për të lexuar - përbëhet prej dy komponentëve të cilat përfshijnë:

1. Leximi për kënaqësi
2. Leximi për informacion – që përdoret si mjet për arritjen e qëllimeve individuale në shoqëri (ndryshe quhet lexim për të bërë).

Lexuesit konsiderohen se duke njohur strategji të efektshme të leximit dhe mënyrën se si reflektojnë mbi të lexuarit (atë që kanë lexuar), ndërtojnë një kuptim në mënyrë aktive të bazuar në tekstin e caktuar. Lexuesit përpara, gjatë dhe pas leximit, për ta ndërtuar kuptimin për atë që e lexojnë përdorin një gamë të gjerë të aftësive gjuhësore, strategjive njohëse, metakognitive, si dhe njohuritë bazë.

Përveç kësaj, konteksti i situatës në lexim mund të mbështesë ndërtimin e kuptimit duke nxitur angazhimin dhe motivimin për të lexuar, por konteksti gjithashtu mund të vendosë kërkesa specifike që mund të mos e mbështesin ndërtimin e kuptimit.

## **Numri i nxënësve të vlerësuar**

Në Kosovë vlerësimi PIRLS u realizua nga 15-25 qershor 2021. Për këtë vlerësim janë perzgjedhur 150 shkolla nga të cilat janë perzgjedhur 4874 nxënës të klasave të katërta. Në test kanë marr pjesë 4557 nxënës apo 97% të nxënësve të perzgjedhur.

## Raportimi i Rezultateve të arritjeve të PIRLS 2021

Rezultatet e arritjeve për të gjitha vendet pjesëmarrëse paraqiten në tabelën 1.

**Tabela 1: Arritjet mesatare të leximit dhe shpërndarjet e rezultateve të shkallës**

■ Vlerësimi i vonuar i klasës së katërt në fillim të klasës së pestë

Vendi	Mesatarja	Shpërndarja e arritjeve
Singapor	587 (3.1) ▲	
Irlanda	577 (2.5) ▲	
Hong Kong	573 (2.7) ▲	
Federata Ruse	567 (3.6) ▲	
Irlanada veriore	566 (2.5) ▲	
Anglia	558 (2.5) ▲	
Kroacia	557 (2.5) ▲	
Lituania	552 (2.3) ▲	
Finlanda	549 (2.4) ▲	
Polonia	549 (2.2) ▲	
Shtetet e Bashkuara	548 (6.8) ▲	
Taipei kinez	544 (2.2) ▲	
Suedia	544 (2.1) ▲	
Australi	540 (2.2) ▲	
Bullgaria	540 (3.0) ▲	
Republika Çeke	540 (2.3) ▲	
Hungaria	539 (3.4) ▲	
Danimarka	539 (2.2) ▲	
Norvegjia	539 (2.0) ▲	
Italia	537 (2.2) ▲	
Makao	536 (1.3) ▲	
Austria	530 (2.2) ▲	
Republika Sllovake	529 (2.7) ▲	
Letonia	528 (2.6) ▲	
Holanda	527 (2.5) ▲	
Gjermania	524 (2.1) ▲	
Zelanda e Re	521 (2.3) ▲	
Spanja	521 (2.2) ▲	
Portugalia	520 (2.3) ▲	
Sllovenia	520 (1.9) ▲	
Malta	515 (2.7) ▲	
Franca	514 (2.5) ▲	
Serbia	514 (2.8) ▲	
Shqipëria	513 (3.1) ▲	
Qipro	511 (2.9) ▲	
Belgjikë (Flemisht)	511 (2.3) ▲	
Izrael	510 (2.2) ▲	
Kazakistani	504 (2.7) ▲	
<b>Pika qendrore e shkallës PIRLS</b>	<b>500</b>	
Turqia	496 (3.4) ▼	
Belgjikë (Frëngjisht)	494 (2.7) ▼	
Gjeorgjia	494 (2.6) ▼	
Mali i Zi	487 (1.6) ▼	
Katari	485 (3.7) ▼	
Emiratet e Bashkuara Arabe	483 (1.8) ▼	
Bahrein	458 (2.9) ▼	
Arabia Saudite	449 (3.6) ▼	
Maqedonia e Veriut	442 (5.3) ▼	
Azerbajxhani	440 (3.6) ▼	
Uzbekistani	437 (2.9) ▼	
Omani	429 (3.7) ▼	
Kosova	421 (3.1) ▼	
Brazil	419 (5.3) ▼	
Irani	413 (4.9) ▼	
Jordania	381 (5.4) ▼	
Egjipti	378 (5.4) ▼	
Maroku	372 (4.5) ▼	
Afrika e Jugut	288 (4.4) ▼	

**Në tabelën 1.-** është paraqitur rradhitja e vendeve sipas rezultateve të vlerësimit PIRLS. Kosova renditet e 51-ta (421 pikë) nga 57 vendet pjesëmarrëse. Rezultate më të ulta se Kosova kanë 6 vende (Brazil, Irani, Jordania, Egjipti, Maroku dhe Afrika e Jugut). Nën mesataren e shkallës PIRLS janë gjithësej 19 vende, ku nga vendet e rajonit janë Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

**Tabela 2.: Mesatarja e arritjeve në lexim sipas gjinisë**

■ *Vlerësimi i vonuar i klasës së katërt në fillim të klasës së pestë*


Vendi	Vajza		Djem		Dallimi
	Përqindja e nxënësve	Mesatarja	Përqindja e nxënësve	Mesatarja	
Spanja	47 (0.9)	522 (2.6)	53 (0.9)	520 (2.5)	2 (2.6)
Republika Çeke	49 (0.9)	541 (2.8)	51 (0.9)	538 (2.7)	4 (3.0)
Izrael	50 (1.1)	512 (2.8)	50 (1.1)	508 (2.6)	4 (3.0)
Portugalia	48 (0.7)	523 (2.3)	52 (0.7)	517 (2.7)	6 (2.0)
Malta	46 (3.4)	518 (3.6)	54 (3.4)	512 (3.2)	6 (4.1)
Italia	49 (0.6)	541 (2.4)	51 (0.6)	534 (2.4)	7 (2.0)
Shtetet e Bashkuara	50 (1.3)	551 (7.2)	50 (1.3)	544 (7.1)	7 (4.4)
Belgjikë (Flemisht)	49 (0.8)	515 (2.6)	51 (0.8)	507 (2.8)	8 (2.8)
Hong Kong	51 (1.0)	577 (2.8)	49 (1.0)	569 (3.3)	8 (2.8)
Republika Sllovake	52 (0.9)	533 (2.9)	48 (0.9)	525 (3.2)	8 (2.8)
Qipro	51 (0.7)	515 (3.2)	49 (0.7)	506 (3.1)	9 (2.7)
Serbia	49 (0.8)	518 (3.4)	51 (0.8)	509 (3.2)	9 (3.5)
Makao	50 (0.7)	540 (1.5)	50 (0.7)	531 (1.9)	10 (2.2)
Anglia	51 (0.9)	562 (3.1)	49 (0.9)	553 (3.1)	10 (3.7)
Belgjikë (Frëngjisht)	49 (0.8)	499 (3.2)	51 (0.8)	489 (2.9)	10 (3.2)
Kroacia	48 (0.9)	562 (3.0)	52 (0.9)	551 (3.0)	10 (3.3)
Irlanda	49 (1.0)	583 (3.3)	51 (1.0)	572 (2.8)	11 (3.5)
Danimarka	52 (0.6)	545 (2.5)	48 (0.6)	533 (2.8)	12 (3.0)
Holanda	50 (0.8)	534 (2.9)	50 (0.8)	521 (2.8)	13 (2.6)
Tajvani	48 (0.5)	551 (2.5)	52 (0.5)	537 (2.4)	13 (2.3)
Federata Ruse	49 (0.7)	574 (3.4)	51 (0.7)	561 (4.5)	13 (3.7)
Franca	50 (0.7)	521 (3.0)	50 (0.7)	507 (2.7)	14 (2.6)
Austria	49 (0.9)	537 (2.6)	51 (0.9)	523 (2.6)	14 (2.7)
Hungaria	50 (1.0)	547 (3.7)	50 (1.0)	532 (4.0)	15 (3.4)
Suedia	50 (0.9)	551 (2.5)	50 (0.9)	536 (2.3)	15 (2.3)
Bullgaria	48 (0.9)	548 (3.0)	52 (0.9)	533 (4.0)	15 (3.9)
Gjermania	49 (0.8)	532 (2.5)	51 (0.8)	516 (2.5)	15 (2.6)
Egjipti	49 (1.5)	386 (5.7)	51 (1.5)	370 (6.4)	16 (5.6)
Norvegjia	49 (0.7)	547 (2.3)	51 (0.7)	531 (2.4)	16 (2.4)
Katari	51 (1.6)	493 (4.2)	49 (1.6)	476 (4.8)	17 (5.0)
Irani	46 (2.3)	422 (7.5)	54 (2.3)	405 (5.9)	17 (9.1)
Turqia	49 (0.6)	505 (3.8)	51 (0.6)	488 (3.6)	17 (2.8)
Kazakistani	50 (0.7)	512 (2.8)	50 (0.7)	495 (3.3)	17 (2.7)
Australia	50 (0.7)	549 (2.5)	50 (0.7)	532 (2.8)	17 (3.0)
Finlanda	50 (0.8)	558 (2.7)	50 (0.8)	541 (2.7)	18 (2.7)
Singapor	49 (0.6)	596 (3.0)	51 (0.6)	578 (3.7)	18 (2.7)
Azerbajxhani	47 (0.8)	450 (4.1)	53 (0.8)	432 (4.0)	18 (3.7)
Sllovenia	49 (0.7)	529 (2.1)	51 (0.7)	511 (2.3)	18 (2.3)
Zelanda e Re	49 (0.7)	531 (2.9)	51 (0.7)	512 (2.7)	19 (3.2)
Mali i Zi	48 (0.6)	497 (2.0)	52 (0.6)	478 (2.2)	20 (2.6)
Polonia	47 (1.0)	560 (2.5)	53 (1.0)	540 (2.7)	20 (2.9)
Shqipëria	49 (1.0)	523 (3.5)	51 (1.0)	503 (3.4)	20 (3.2)
Kosova	51 (0.9)	431 (3.1)	49 (0.9)	410 (3.8)	21 (3.1)
Lituania	50 (0.8)	563 (2.5)	50 (0.8)	542 (2.7)	21 (2.8)
Gjeorgjia	49 (0.8)	506 (2.8)	51 (0.8)	483 (3.1)	23 (2.9)
Brazil	49 (1.1)	431 (6.0)	51 (1.1)	408 (6.1)	23 (6.0)
Uzbekistani	48 (0.9)	449 (3.1)	52 (0.9)	425 (3.5)	24 (3.4)
Irlanada Veriore	52 (1.0)	578 (2.9)	48 (1.0)	553 (3.1)	24 (3.4)
Maqedonia e Veriut	51 (1.0)	454 (5.8)	49 (1.0)	429 (6.0)	25 (5.2)
Letonia	49 (1.3)	542 (2.6)	51 (1.3)	514 (3.3)	27 (3.1)
Emiratet e Bashkuara Arabe	51 (1.7)	497 (2.7)	49 (1.7)	468 (3.6)	29 (5.2)
Maroku	48 (0.8)	390 (4.5)	52 (0.8)	356 (5.2)	33 (3.7)
Arabia Saudite	58 (1.5)	464 (5.0)	42 (1.5)	428 (4.9)	35 (6.8)
Omani	50 (0.6)	447 (4.2)	50 (0.6)	412 (4.1)	36 (3.8)
Jordania	51 (2.6)	398 (6.8)	49 (2.6)	362 (7.9)	36 (10.3)
Bahreini	50 (1.1)	483 (3.9)	50 (1.1)	434 (3.2)	49 (4.5)
Afrika e Jugut	49 (0.6)	317 (4.4)	51 (0.6)	260 (5.0)	57 (3.6)
<b>Mesatarja nderkombëtare</b>	<b>50 (0.1)</b>	<b>512 (0.5)</b>	<b>50 (0.1)</b>	<b>494 (0.5)</b>	

**Në tabelën 2.-** janë paraqitur rezultatet sipas gjinisë. Nga tabela vërejmë se në të gjitha vendet pjesëmarrëse vajzat kanë performuar më mirë se sa djemtë. Në nivelin ndërkombëtar vajzat kanë 18 pikë më shumë se sa djemtë. Dallimin më të vogël e ka Spanja me vetëm 2 pikë dallim, ndërsa dallimin më të madhë e ka Afrika e Jugut me 57 pikë dallim. Në Kosovë vajzat kanë performuar me 21 pikë më shumë se djemtë, që është afër mesatares ndërkombëtare .

Vlerësimi PIRLS në secilin prej qëllimeve të vlerësimit (leximi për kënaqësi dhe leximi për informacion) vlerëson katër proceset e të kuptuarit:

1. Fokusimi dhe marrja e informacionit të dhënë në mënyrë eksplicite,
2. Nxjerrja e konkluzioneve të drejtpërdrejta,
3. Interpretimi dhe integrimi i ideve dhe informacionit,
4. Vlerësimi dhe kritika e përmbajtjes dhe elementeve të tekstit.

**Standardet Ndërkombëtare në PIRLS** - ofrojnë një interpretim të mesatares së rezultateve të PIRLS 2021. Arritjet përmbliidhen në shkallë (PIRLS) për kuptimin e leximit në klasën e katërt.



Kjo përshkruhet në katër pika sipas shkallës ndërkombëtare (STANDARDIT):  
Standardi ndërkombëtar i avancuar - me 625  
Standardi i lartë – me 550  
Standardi i mesëm me 475  
Standardi i ulët me 400

### **Aftësitë dhe strategjitë e të kuptuarit të leximit të demonstruara në PIRLS 2021-**

paraqiten bazuar në Standardet Ndërkombëtare të PIRLS 2021, të cilat ndërtohen duke përfaqësuar aftësitë dhe strategjitë e të kuptuarit të leximit sipas kërkesave të secilit standard (i ulët, i mesëm, i lartë dhe i avancuar). Nxënësit të cilët arrijnë një pikë referimi të caktuar ata gjithashtu kanë arritur të gjitha standardet e mëparshme. Për shembull, nxënësit që arrijnë standardin e avancuar ata gjithashtu kanë arritur nivelin standardit të ulët, mesatar, dhe standardin e lartë. Në përputhje me dy qëllimet e leximit që ofron Korniza e Vlerësimit të Leximit PIRLS 2021 për tekstet letrare dhe informative si dhe kërkesat (pyetjet) të ndërtuara për to.